

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

**“SHËRBIME PASTRIMI NË MJEDISËT
E HOTELIT DHE LAVANDERI”**

Kodi: PK-G-13-25

Njësia e të nxënit të standardit të kualifikimit “Hoteleri”, K-G9-III-24, Niveli III I KSHK-së:

1. NjN G9-07-III-0084-24 “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

Miratoi:

MINISTRI

1.Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
2 Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Certifikimi sipas Nivelit të III të KSHK-së për njësinë e të nxënit “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi” me kod G9-07-III-0084-24, do të jepet nga IoAFP i akredituar sipas Urdhrit nr. 845, datë 03.07.2025 “Për miratimin e rregullores për standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional”

Tiranë, 2025

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“SHËRBIME PASTRIMI NË MJEDISËT E HOTELIT DHE LAVANDERI”

(PK-G-13-25)

I. Profili profesional i punonjësit të shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderi.

a) Karakteristikat e punonjësit të shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderi.

Punonjësi i shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderi do të kryejë detyra profesionale si i punësuar apo i vetëpunësuar në kompani që ofrojnë shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punonjësi i shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderi duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe **shprehi** praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderi.

Suksesi i punonjësit të shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderi është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje (qëndrime)** të tilla si: ndershmëria, integriteti, besueshmëria, profesionalizmi, shkathtësia, durimi, kujdesi, përqëndrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina, fleksibiliteti, bashkëpunimi, vetëkontrolli, përgjegjshmëria, aftësi organizative etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punonjësit të shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit.

Profesioni i punonjësit të shërbimeve të pastrimit në mjediset e hotelit dhe lavanderisë është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për këto shërbime. Kursanti mund të punësohet në kompani që ofrojnë shërbime pastrimi në mjediset e hotelit, lavanderi ose në struktura të tjera të mikpritjes, si dhe të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shërbimeve të pastrimit dhe lavanderisë.

Me përmbushjen e të gjitha njësive të të nxëniet të standardit të kualifikimit “Hoteleri”, Niveli III i KSHK-së, si dhe me përvojë pune, kursanti mund të kalojë në nivelet e mëtejshme të KSHK-së. Për të zhvilluar aktivitet privat për vetëpunësim në shërbime pastrimi dhe lavanderi, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit. Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale dhe aftësi të buta (soft skills) për të ushtruar disa veprimtari profesionale të përfshira në profesionin: “Punonjës i kualifikuar në hotel dhe restorant”, me kode 512, 513, 5151, 4222, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi”

Në përfundim të Kursit “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi” kursantët do të jenë të aftë:

- të kryejnë shërbime pastrimi në dhomën e klientit;
- të kryejnë shërbime pastrimi të tualetit në dhomë dhe ambiente të përbashkëta;
- të kryejnë shërbime pastrimi në ambientet e përbashkëta në hotel/struktura të mikpritjes;
- të zbatojnë procedurat e pranimit dhe dorëzimit të rrobave në lavanderi;
- të zbatojnë procesin e larjes dhe tharjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi;
- të zbatojnë teknikat e hekurosjes dhe palosjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi.;
- të garantojnë kushte cilësore për mikpritje dhe qëndrimin komfort të klientit;
- të zbatojnë rregullat e hyrjes në dhomën e klientit;
- të zbatojnë rregullat për trajtimin e sendeve personale të klientëve;
- të përdorin elemente të estetikës për dekorimin e dhomës së klientit dhe ambienteve të përbashkëta;
- të zbatojnë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi” duhet të mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar dhe të jenë mbi 16 vjeç.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi”.

253 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderi	MK-G-424-25	33 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan detyrat e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderisë. 2. Kursanti përshkruan pajisjet, mjetet dhe produktet e pastrimit dhe lavanderisë. 3. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në shërbime pastrimi dhe lavanderi.
2	Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit	MK-G-425-25	130 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen proceset e pastrimit të dhomës në hotel. 2. Kursanti kryen proceset e pastrimit të tualetit në hotel. 3. Kursanti kryen proceset e pastrimit të mjediseve të përbashkëta të hotelit.
3	Shërbime në lavanderi	MK-G-426-25	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan proceset e organizimit të punës në lavanderi. 2. Kursanti zbaton procedurat e pranimit dhe dorëzimit të rrobave në lavanderi. 3. Kursanti zbaton procesin e larjes dhe tharjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi. 4. Kursanti zbaton teknikat e hekurosjes dhe palosjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi.

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënit që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MEI.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit dhe lavanderi”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderi”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E PUNONJËSIT TË SHËRBIMEVE TË PASTRIMIT DHE LAVANDERI	MK-G-424-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi praktike për të përshkruar detyrat e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderisë, pajisjet, mjetet dhe produktet bazë të pastrimit dhe lavanderisë, si dhe rregullat e sigurimit teknik në shërbime pastrimi dhe lavanderi.	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan detyrat e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së proceseve të pastrimit në hotel; - të shpjegojë rëndësinë e mikpritjes së klientit, duke garantuar cilësi dhe kushte për qëndrim komfort në hotel; - të shpjegojë lidhjen mes garantimit të shërbimeve të pastrimit me imazhin, reputacionin dhe garantimin e standardeve të shërbimit të hotelit; - të dallojë shërbimet e përgjithshme në dhomë nga shërbimet individuale për klientin; - të argumentojë rëndësinë e vlerësimeve dhe komentet e klientëve online lidhur me shërbimet e pastrimit në imazhin e hotelit; - të përshkruajë rolin e stafit të shërbimeve të pastrimit në garantimin e cilësisë së shërbimeve për klientin në hotel; - të shpjegojë rëndësinë e kryerjes me standarde të shërbimeve të pastrimit, për sigurimin e higjienës dhe të shëndetit në hotel; - të shpjegojë lidhjen ndërmjet shërbimeve të pastrimit dhe	

-
- parandalimit të dëmtimeve/ruajtjes së infrastrukturës së hotelit/biankerive/rrobave të klientit;
- të argumentojë rëndësinë e kryerjes së shërbimeve cilësore të pastrimit në përmbushje të standardeve ligjore dhe profesionale në hotel;
 - të shpjegojë lidhjen mes standardit të shërbimeve të pastrimit dhe efikasitetit në punë të punonjësve;
 - të shpjegojë rëndësinë e gadishmërisë së punonjësve të shërbimeve të pastrimit për të organizuar dhe menaxhuar kohën e punës dhe për t'i kushtuar vëmendje detajeve;
 - të shpjegojë aspektin ekonomik dhe mjedisor të kryerjes me cilësi të shërbimeve të pastrimit;
 - të shpjegojë lidhjen mes pastërtisë, komunikimit dhe qëndrimit profesional të punonjësve të pastrimit me klientët, për një përvojë pozitive;
 - të shpjegojë rëndësinë e trajnimit të vazhduar profesional të stafit të shërbimeve të pastrimit në hotel;
 - të përshkruajë strukturën organizative të departamentit të shërbimeve të pastrimit (housekeeping);
 - të përshkruajë detyrat e personelit, sipas strukturës dhe hierariksë;
 - të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të detyrave periodike/planit të shërbimeve të pastrimit;
 - të përshkruajë mënyrën e organizimit të karrocës së pastrimit, sipas llojit të shërbimit;
 - të përshkruajë rregullat e hyrjes në dhomën e klientit (trokitja, prezantimi, kërkesa për leje, etj.);
 - të shpjegojë mënyrën e raportimit të objekteve të humbura, të gjetura apo të dëmtuara në dhomën e klientit;
 - të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së privatësisë së klientëve;
 - të përshkruajë procedurat për trajtimin e rrobave të klientit në lavanderi;
 - të shpjegojë rëndësinë e bashkëpunimit me stafin e departamenteve/sectorëve të tjerë në hotel;
 - të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të evidencave ditore/listës së vlerësimit, gjatë veprimtarisë ditore;
 - të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të listave të kontrollit, gjatë shërbimeve të pastrimit, sipas standardit;
 - të shpjegojë mënyrat e raportimit të veprimtarisë ditore të punës;
 - të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë, gjatë veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.



RN 2 Kursanti përshkruan pajisjet, mjetet dhe produktet e pastrimit dhe lavanderisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e përdorimit dhe të mirëmbajtjes së pajisjeve dhe mjeteve të punës, gjatë veprimtarisë profesionale;
- të përshkruajë pajisjet, mjetet dhe materialet e nevojshme të punës për shërbimet e pastrimit në hotel;
- të përdorë pajisje, mjete dhe materiale profesionale për kryerjen e shërbimeve të pastrimit në hotel;
- të përdorë dhe mirëmbajë pajisjet dhe mjetet e punës, sipas manualeve teknike dhe sipas standardit;
- të organizojë karrocën e pastrimit, sipas rregullit dhe standardit;
- të përshkruajë llojet e detetgjenteve dhe dezinfektuesve që përdoren në shërbimet e pastrimit në hotel;
- të përdorë detergjentët dhe dezinfektuesit, sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- të interpretojë etiketat dhe shenjat dalluese të produkteve kimike (për rrezik, përqëndrim, përdorim etj.);
- të kujdeset për zbatimin e rregullave të higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë veprimtarisë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik në shërbime pastrimi dhe lavanderi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e respektimit të udhëzimeve të hotelit për procedurat e sigurisë;
- të shpjegojë rreziqet që mund të shfaqen, gjatë përdorimit të mjeteve elektrike dhe kimikateve të pastrimit;
- të përshkruajë masat mbrojtëse personale dhe kolektive (përdorimi i dorezave, maskës, uniformës, këpucëve të përshtatshme);
- të shpjegojë mënyrën e kontrollit të pajisjeve dhe mjeteve të punës për defekte, përpara fillimit të përdorimit të tyre dhe raportimit për to;
- të zbatojë rregullat e përdorimit të makinave larëse, tharëse dhe hekurosëse, sipas manualeve të prodhuesit;
- të interpretojë simbolet dhe të dhënat e etiketave të produkteve pastruese dhe rrobave;
- të zbatojë rregullat e sigurisë në rast aksidenti ose emergjence (zjarr, rrëshqitje, derdhje kimikatesh etj.);

- të përdorë tabelat sinjalizuese për sigurinë, gjatë veprimtarisë profesionale në hotel;
- të respektojë legjislacionin bazë të mbrojtjes në punë dhe rregulloret e brendshme të institucionit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në hotele ku kryhen shërbime pastrimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra për të përshkruar detyrat e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderisë, pajisjet, mjetet dhe produktet bazë të pastrimit dhe lavanderisë, si dhe rregullat e sigurimit teknik në shërbime pastrimi dhe lavanderi.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike për të përshkruar detyrat e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderisë, pajisjet, mjetet dhe produktet bazë të pastrimit dhe lavanderisë, si dhe rregullat e sigurimit teknik në shërbime pastrimi dhe lavanderi.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të nxënës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për pastrimin e mjediseve të hotelit dhe lavanderisë.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Shërbime pastrimi në mjediset e hotelit”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME PASTRIMI NË MJEDISET E HOTELIT	MK-G-425-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi praktike për të kryer proceset dhe procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të dhomës së klientit, ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve në hotel.	
Kohëzgjatja e modulit	130 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar, të jenë mbi 16 vjeç, si dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderi”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti kryen proceset e pastrimit të dhomës në hotel. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të veshë uniformën profesionale në vendin e punës; - të përgatitë karrocën e pastrimit për higjienizimin/ pastrimin e dhomave, sipas planit të punës; - të sistemojë në karrocë solucionet e pastrimit, furçat, materialet e pastrimit, sipas rregullit; - të përzgjedhë solucionet e nevojshme për pastrim, sipas standardit; - të shpjegojë rëndësinë e përzgjedhjes dhe përdorimit të solutioneve ekologjike për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin në punë; - të përgatitë fshesën me korent për pastrimin e dhomës së klientit; - të zbatojë rregullat për hyrjen në dhomën e klientit; - të ajrosë dhomën e klientit, sipas standardit; - të seleksionojë mbeturinat dhe pastrojë koshin, sipas rregullit; - të largojë çarçafët dhe këllëfët (biankeritë) e përdorura, sipas rregullit; - të kryejë procesin e rregullimit të krevatit, sipas standardit; - të vendosë në qese biankeritë e përdorura, sipas standardit; - të kryejë procesin e shtrimit të çarçafëve dhe vendosjes së këllëfëve (biankerive), sipas standardit; - të rregullojë mbulesat e krevatit, duke përdorur elemente të estetikës sipas standardit; - të pastrojë pluhurat në dhomën e klientit, sipas procedurës; - të pastrojë dhe dizifektojë aksesoret në dhomën e klientit, sipas procedurës;	

-
- të pastrojë dyshtemenë dhe tapetin me fshesë me korent, sipas rregullit;
 - të lajë xhamat e dhomës së klientit, sipas procedurës;
 - të pastrojë mobiljet në dhomë, sipas rregullit;
 - të kontrollojë funksionimin e pajisjeve në dhomë, sipas rregullit;
 - të evidentojë dëmtime apo defekte të mundshme në dhomën e klientit, sipas rregullit;
 - të vendosë materialet informative për klientin, sipas standardit;
 - të informojë eprorët për sendet e gjetura në dhomë, sipas procedurës;
 - të kompletojë dhomën, sipas listës së inventarit, sipas standardit;
 - të kontrollojë përdorimin e minibarit nga klientit, sipas fletë inventarit;
 - të plotësojë minibarin me produktet e duhura, sipas fletë inventarit;
 - të raportojë te eprorët mbi dhomat e zëna dhe përdorimin e minibarit, sipas procedurës;
 - të përdorë me efikasitet burimet e ujit, energjisë dhe materialeve të tjera, gjatë shërbimit të pastrimit në dhomë;
 - të përdorë teknologjinë në funksion të veprimtarisë profesionale gjatë procesit të pastrimit të dhomës së klientit;
 - të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të praktikave të gjelbra gjatë pastrimit të dhomës së klientit;
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti kryen proceset e pastrimit të tualetit në hotel.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të përshkruajë rreziqet kryesore, gjatë pastrimit të tualetit dhe masat për parandalimin e aksidenteve;
- të përdorë dorezat për pastrimin e tualetit të dhomës së klientit, sipas standardit;
- të përdorë materialet e duhura për pastrimin e tualetit, sipas standardit;
- të pastrojë dhe higjienizojë koshin e tualetit, sipas standardit;
- të ndajë dhe largojë mbeturinat, sipas standardit;
- të pastrojë dhe dezinfektojnë dorezat e derës së tualetit, sipas standardit;
- të seleksionojë peshqirat, sipas llojit dhe përdorimit;

- të vendosë në tualet peshqirat e pastër, sipas standardit;
- të kontrollojë funksionimin e pajisjeve në tualetin e dhomës, sipas standardit;
- të kryejë procesin e pastrimit dhe dezinfektimit të WC-së dhe furçës së WC-së, sipas standardit;
- të pastrojë dhe dezinfektojë vaskën/ambientin e dushit, sipas standardit;
- të pastrojë lavamanin me pasqyrën e tualetit, sipas standardit;
- të kryejë procesin e shkëlqimit të pjesëve me përbërje metalike në tualetin e dhomës, sipas standardit;
- të kompletojë tualetin e dhomës së klientit me materialet e konsumit (amenities), sipas standardit;
- të pastrojë dyshtemenë, pllakat dhe derën e tualetit, sipas standardit;
- të konstatojë dhe raportojë (me check list) dëmtime apo defekte të mundshme në tualetin e dhomës;
- të përdorë me efikasitet burimet e ujit, energjisë dhe materialeve të tjera, gjatë pastrimit të tualetit;
- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të praktikave të gjelbra, gjatë pastrimit të tualetit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti kryen proceset e pastrimit të mjediseve të përbashkëta të hotelit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë procesin e përgatitjes së mjeteve të punës, sipas standardit;
- të veshë uniformën profesionale në vendin e punës;
- të përshkruajë rreziqet kryesore, gjatë pastrimit të ambienteve të përbashkëta, si dhe masat për parandalimin e aksidenteve;
- të përgatitë karrocën për higjienizimin/ pastrimin e mjediseve të përbashkëta, sipas planit të punës;
- të ajrosë hollin dhe ambientet e tjera të përbashkëta, sipas rregullit;
- të lajë hollin e hotelit me solucione të përshtatshme (ekologjike), sipas standardit;
- të pastrojë tapetet në ambientet e përbashkëta me fshesë me korenti, sipas rregullit;
- të pastrojë dhe lajë shkallët dhe ashensorët, sipas standardit;
- të kryejë procesin e pastrimit të tualeteve në hollin e hotelit, sipas standardit;

- të kompletojë tualetet me materiale konsumi, sipas standardit;
- të kryejë procesin e pastrimit të zyrave të administratës, sipas standardit;
- të largojë pluhurat në recepsion, vitrina, piktura, vepra artit të vendosura në ambiente të përbashkëta/zyra, sipas standardit;
- të kujdeset për lulet e mjediset e përbashkëta të hotelit, sipas standardit;
- të kujdeset për përdorimin e elementeve të estetikës, në dekorimin e ambienteve të përbashkëta;
- të vendosë tabelat/sinjalistikën e mbrojtjes ndaj aksidenteve/incidenteve në mjediset e përbashkëta;
- të përdorë teknologjinë në funksion të veprimtarisë profesionale, gjatë procesit të pastrimit;
- të kujdeset për pastrimin e ambientit rreth pishinës dhe mjediseve sportive, sipas standardit;
- të kujdeset për pastrimin e ambienteve të shëndetit/SPA, sipas standardit;
- të përdorë me efikasitet burimet e ujit, energjisë dhe materialeve të tjera, gjatë shërbimit të pastrimit;
- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të praktikave të gjelbra, gjatë pastrimit të ambienteve të përbashkëta;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në vendin e punës;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në hotele ku kryhen shërbime pastrimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra për të kryer proceset dhe procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të dhomës së klientit, ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve në hotel.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike për të kryer proceset dhe procedurat e pastrimit dhe higjienizimit të dhomës së klientit, ambienteve të përbashkëta dhe tualeteve në hotel.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të nxënës.

Kushtet e e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: – Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. – Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, mjetet, veglat, pajisjet dhe instrumentet për pastrimin e ambienteve dhe tualeteve në hotel. – Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	---

3. Moduli “Shërbime në lavanderi”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	SHËRBIME NË LAVANDERI	MK-G-426-25
Qëllimi i modulit	Një modul që i pajis kursantët me njohuri dhe aftësi praktike për proceset e organizimit të punës në lavanderi, zbatimin e procedurave të pranimit dhe dorëzimit të rrobave, zbatimin e procesit të larjes dhe tharjes së tekstileve dhe veshjeve, me zbatimin e teknikave të hekurosjes dhe palosjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar 9-vjeçar, të jenë mbi 16 vjeç, si dhe të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e punonjësit të shërbimeve të pastrimit dhe lavanderi”.	
Rezultatet e të nxënësit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan proceset e organizimit të punës në lavanderi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rolin dhe funksionet e lavanderisë në hotel; - të shpjegojë organizimin e departamentit të lavanderisë, pozicionet kryesore të punës dhe ndërveprimin me sektorët e tjerë; - të përshkruajë parimet e higjienës dhe rëndësinë e uniformës së punës dhe mjeteve mbrojtëse në lavanderi; - të shpjegojë rëndësinë e sigurisë dhe kujdesit ndaj shëndetit në lavanderi; - të përshkruajë rreziqet kryesore në lavanderi dhe masat për parandalimin e aksidenteve; - të shpjegojë rregullat ergonomike në lavanderi për parandalimin e dëmtimeve dhe rritjen e efikasitetit të punës; - të përshkruajë proceset e punës në lavanderi nga pranimi deri te dorëzimi dhe ruajtja e tekstileve dhe veshjeve; - të përshkruajë pikat kritike të kontrollit, gjatë procesit të punës në lavanderi; - të shpjegojë funksionin e çdo zone/sektori në lavanderi; - të përshkruajë procedurat standarde të përdorimit të detergjenteve pastrues dhe ndihmës në lavanderi (SDS); - të shpjegojë sistemin e inventarizimit të detergjenteve të pastrimit dhe ndihmës në lavanderi; - të përshkruajë llojet e fijeve tekstile, metodat e endjes dhe llojet e përbërjes së pëlhurave;	

- të përshkruajë llojet e detergjenteve pastrues dhe ndihmësit, sipas proceseve;
- të shpjegojë sjelljen e materialeve tekstile ndaj ujit, temperaturës, detergjentëve;
- të përshkruajë etiketat e kujdesit dhe simbolikat e larjes;
- të përshkruajë përdorimin e tekstileve dhe veshjeve në hotel, si dhe proceset kryesore të pastrimit, sipas llojit;
- të shpjegojë hapat dhe procedurat për trajtimin e njollave në lavanderi;
- të përshkruajë procedurat e trajtimit të tekstileve e veshjeve, sipas llojit në lavanderi;
- të përshkruajë pajisjet dhe mjetet e punës që përdoren në lavanderi;
- të mirëmbajë pajisjet dhe mjetet e punës në lavanderi, sipas procedurave dhe të raportojë defektet;
- të zbatojë legjislacionin, gjatë ushtrimit të veprimtarive në lavanderi;
- të përdorë sisteme digjitale për menaxhimin e porosive, tekstileve dhe veshjeve, si dhe detergjentëve pastrues dhe ndihmës në lavanderi;
- të plotësojë formularët standarde të porosisë dhe faturimit;
- të përdorë dokumentacionin teknik, gjatë punës në lavanderi;
- të shpjegojë rëndësinë e praktikave të gjelbra në lavanderi;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në lavanderi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti zbaton procedurat e pranimit dhe dorëzimit të rrobave në lavanderi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshëndesë klientin/kolegët në mënyrë profesionale dhe të sjellshme;
- të kontrollojë gjendjen e tekstileve, veshjeve (njolla, grisje, dëmtime) para pranimit;
- të identifikojë saktësinë e llojit të tekstilit dhe mënyrën e larjes nga etiketa;
- të zbatojë procedurat e etiketimit dhe kodifikimit të tekstileve, veshjeve;
- të vlerësojë udhëzimet e klientëve në lidhje me trajtimin e tekstileve, veshjeve;
- të informojë klientin në lidhje me listën e çmimeve;
- të llogaritë saktë peshën/sasinë e artikujve dhe konfirmojë faturën paraprake;
- të komunikojë qartë për klientin afatin e marrjes së

- tekstilit/veshjes dhe çmimin e shërbimit;
- të ndajë tekstilet, veshjet, sipas ngjyrave, llojit të tekstilit dhe shkallës së ndotjes;
- të vendosë saktë etiketat e paralajmërimit nëse janë të nevojshme (p.sh. vetëm larje e thatë);
- të kontrollojë gjatë dorëzimit të tekstileve nëse porosia e klientit është e plotë dhe korrekte;
- të kontrollojë identitetin e klientëve para dorëzimit të porosisë;
- të dorëzojë veshjet e klientëve në mënyrë profesionale (pa rrudha, të palosura mirë);
- të zbatojë procedurat dhe dokumentacionin e brendshëm për qarkullimin dhe magazinimin e tekstileve, veshjeve në hotel;
- të zbatojë procedurat për artikujt e harruar në xhepa dhe veshjet e harruara;
- të përdorë dokumentacionin teknik, gjatë punës në lavanderi;
- të shpjegojë rëndësinë e praktikave të gjelbra në lavanderi;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në lavanderi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti zbaton procesin e larjes dhe tharjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të ndajë dhe seleksionojë tekstilet/veshjet sipas materialeve dhe simboleve të kujdesit në etiketat e rrobave;
- të trajtojë njollat përpara larjes së tekstileve;
- të transportojë, peshojë dhe vendosë në makineri tekstilet dhe veshjet e seleksionuara;
- të zgjedhë programin e duhur të larjes, sipas llojit të tekstilit (pambuk, lesh, sintetike etj.);
- të matë dozën e saktë të detergjentëve pastrues dhe ndihmëse;
- të aplikojë teknika të tjera për heqjen e njollave para-larje (pre spotting);
- të monitorojë ciklin e larjes, ujin dhe ndërhyjë në raste problemesh (p.sh. mungesë uji, shkumë e tepërt);
- të zbatojë programet dhe rregullat për larjen e rrobave delikate;
- të zgjedhë saktë programin për tharjen e rrobave në makineri për të ruajtur tekstilet e veshjet nga tkurrja;
- të përdorë dollapet e tharjes për tekstilet delikate;
- të kontrollojë tekstilet dhe veshjet pas tharjes dhe të kryejë riparime në rast nevojë (qepje, kopsa etj.);
- të pastrojë filtrat e tharëses pas çdo larje ose sipas kërkesave

- specifike të makinerisë;
- të demostrojë njohuri për efektin e pH- it në procesin e larjes dhe shpëlarjes;
- të largojë materialet e mbetura nga makineritë pas larjes dhe tharjes së tekstileve dhe veshjeve;
- të zbatojë protokollet e dezinfektimit nëse aplikohen;
- të zbatojë procedurat e kursimit të kimikateve dhe shmangies së ndotjes mjedisore;
- të shpjegojë rëndësinë e praktikave të gjelbra në lavanderi;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në lavanderi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti zbaton teknikat e hekurosjes dhe palosjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë ndarjen dhe përgatitjen e tekstileve dhe veshjeve për hekurosjen manuale apo me makineri;
- të zgjedhë temperaturën dhe avullin e duhur të hekurit, sipas llojit të tekstileve;
- të përdorë teknikat e hekurosjes për të mos dëmtuar ose shkëlqyer sipërfaqen e tekstileve, veshjeve;
- të hekurosë tekstilet, veshjet, sipas standardit;
- të palosë tekstilet dhe veshjet, sipas standardeve dhe rregullave në mënyrë uniforme;
- të përdorë sipas manualit makineritë automatike të palosjes dhe hekurosjes industriale;
- të paketojë rrobat e hekurosura, duke përdorur mjetet e duhura (varëse, qese);
- të zbatojë procedurat e qarkullimit të brendshëm dhe ruajtjen e tekstileve në lavanderi dhe magazina;
- të mirëmbajë e pastrojë mjedisin e punës pas përfundimit të çdo detyre;
- të kryejë pastrimin ditor të brendshëm e të jashtëm të lavatriçeve dhe tharëseve;
- të inspektojë rregullisht gjendjen e makinerive për defekte (rrjedhje, dëmtime etj.);
- të zbatojë procedurat e raportimit të defekteve;
- të kontrollojë e pastrojë rregullisht filtrat e ajrit, pompave dhe shkarkimit;
- të mirëmbajë mjetet e punë në gjendje funksionale;
- të demostrojë njohuri për presionin dhe temperaturën e depozitës së ujit në sistemet me avull;
- të sigurojë solucione për hekurin në mënyrë të vazhdueshme

- për të mos pasur ndërprerje në punë;
- të përdorë dhe ruajë manualët e përdorimit të pajisjeve, mjeteve, detergjentëve dhe ndihmësve;
- të zbatojë procedurat e kursimit të detergjenteve të pastrimit, ndihmësve dhe shmangies së ndotjes mjedisore;
- të shpjegojë rëndësinë e praktikave të gjelbra në lavanderi;
- të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit në lavanderi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vlerësimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të praktikave mësimore. Rekomandohen dhe vizita në hotele ku kryhen shërbime lavanderie.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës të praktikave mësimore. Atyre duhet t'u jepen detyra të përshkruajnë proceset e organizimit të punës në lavanderi, zbatimin e procedurave të pranimit dhe dorëzimit të rrobave, zbatimin e procesit të larjes dhe tharjes së tekstileve dhe veshjeve, zbatimin e teknikave të hekurosjes dhe palosjes së tekstileve dhe veshjeve në lavanderi.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjithave kritereve të vlerësimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës të pajisura me materialet, veglat, pajisjet dhe instrumentet, detergjentë pastrimi dhe ndihmës, për kryerjen e veprimtarive në modul.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, standarde, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-